



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 24.01.2014  
Nr.0204-120

**PËR:** Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës  
Haxhi Ibishi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

**LËNDA:** KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS Nr. 07-265/14 të pranuar më datën 24.01.2014

Të nderuar/a,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 07-265/14 të miratuar me datën 10.01.2014 nga Kuvendi i Komunës së Klinës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik prodhon efekt të plotë juridik

- Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete

Me respekt,

Slobodan Petrović,  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana: 24.01.2014  
Br.0204-120

Za : **Sokol Bashota**, Gradonačelnik Opštine Klina  
**Haxhi Ibishi**, Predsedvajući Skuštine Opštine Klina

**PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE KLINA Br.07-265/14** primljene dana 24.01.2014

Poštovani-e,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave na osnovu nadležnosti i odgovornosti određene prema članu 81.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, kao i Uredbe br. 02/2011, o poljima Administrativne Odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, dodatak XII, posle razmatranja odluke br.07-265/14 usvojene dana 10.01.2014 od Skupštine Opštine Klina, **POTVRDJUJE** zakonitost akta, i ceni da je isti u skladu sa Zakonodavstvom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt koji ima puni pravni efekat

- Odluka o izboru Odbora za Zajednice

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni Sekretar u MALS-a*  
*Rukovodiocima Uprava MALS-a*  
*Arhivi MALS-a*



Duke u mbështetur në nenin 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 32 dhe 34 dhe 53 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt të mbajtur më 10.01.2014, mori këtë:

## VENDIM

Për

### Themelimin e Komitetit për Komunitete

#### I

Themelohet Komiteti për Komunitete i Komunës së Klinës, si komitet i përhershëm, përbëhet prej 7 anëtarëve me këtë përbërje:

1. Qamile Qitaku-PDK
2. Arben Limani- LDK
3. Tun Dedaj- AAK
4. Vulicevic Nebojse-srpske zajednice
5. Sahit Balija -Egjiptas
6. Nexhmedin Gashi-Rom
7. Gani Vrankaj -Ashkali dhe

Komiteti përfshin në radhët e veta shumicën e thjesht nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë dhe përbejnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve (neni 53 paragrafi 1 i LVL)

#### II

Ky komitet punon konformë dispozitave Ligjore në fuqi: Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (neni 53 paragrafi 2), Statutit të komunës së Klinës dhe Rregullorës për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit dhe Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e komiteteve.

#### III

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale.

### KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 07-265 2014  
Klinë më 23.01 2014

